REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS PUBLIKE**
**DREJTORIA E INTEGRITETIT, MBIKËQYRJES DHE ANKESAVE ADMINISTRATIVE E GJYQËSORE**

Nr. 4359/5 Prot.                                                                                Tiranë, më 14.08.2019

Lënda: Mbi ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë

**Z. Marjel Mejdini**
Rruga: "Zef Jubani", Pallati "Bjorn", Kati 7, Apartamenti 51,

**Tiranë**

Komisioni i Posaçëm, i ngritur pranë Departamentit të Administratës Publike (DAP), me urdhrin nr. 49, datë 18.07.2019, për zbatimin e vendimit Nr. 3819(80-2017-3891) datë 09.10.2017, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, lënë në fuqi me vendimin Nr. 1459 datë 13.05.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit, bazuar në nenin 66/1 të Ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, si dhe në urdhrin nr. 5151/2015 "Për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë nga institucionet e administratës shtetërore, të përfshira në fushën e zbatimit të ligjit për shërbimin civil", shqyrtoi kriteret e përgjithshme e specifike të pozicionit të punës përpara lirimit tuaj, si dhe pozicioneve aktuale të lira në Departamentin e Administratës Publike.

Në zbatim të nenit 158 e vijues të K.Pr. Administrative, në datën 22.07.2019, me shkresat Nr. 4359/1 dhe 4359/2 Prot., Komisioni i Posaçëm ju ka përcjellë propozimin për pozicionin "Përgjegjës i Sektorit të Integritetit dhe Mbikëqyrjes, në Drejtorinë e Integritetit, Mbikëqyrjes dhe Ankesave Administrative e Gjyqësore, në DAP, në të cilën ju plotësoni kushtet e përgjithshme dhe kërkesat e posaçme, me pozicionin që keni patur përpara lirimit.

Në kushtet kur, nga posta shqiptare është kthyer dy herë zarfi me shënimet "e panjohur" dhe "larguar me pushime", ju është lënë shënimi përmes aplikacionit whatts up, për dërgimin e adresës tuaj tw emailit, me qëllim njoftimin e vendimit të Komisionit të Posaçëm, për zbatimin e vendimit tuaj.

Për sa më sipër, në bazë të pikës "b" të nenit 162 të K.Pr. Administrative "Kur vendi për njoftimin nuk është i njohur dhe njoftimi nuk është i mundur, sipas nenit 151 të këtij Kodi", vendosëm njoftimin publik të akteve të Komisionit të Posaçëm, respektivisht në faqen e internetit të DAP dhe në një kënd të posaçëm pranë këtij institucioni. Ndërkohë që një kopje e njoftimit u dërgua dhe në njësinë administrative, ku përfshihet adresa e vendbanimit tuaj.

Sjellim në vëmendjen tuaj se, bazuar në ligjin nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", i ndryshuar, si dhe vendimin nr. 17/2016, të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", Departamenti i Administratës Publike është përgjegjës për marrjen në dorëzim, administrimin dhe përpunimin e formularëve të vetëdeklarimit për nëpunësit në shërbimin civil dhe shërbimin diplomatik, si dhe drejtuesit e çdo niveli në administratën publike të nivelit qendror dhe vendor që nuk përfshihen në shërbimin civil. *(shkronja "gj", e pikës 4, të kreut II, të vendimit nr.17/2016 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë).*

Në respektim të nenit 5, të ligjit nr. 138/2015, i ndryshuar, ju mbartni detyrimin e depozitimit të formularit të vetëdeklarimit, i cili duhet të plotësohet në mënyrë të qartë dhe individualisht prej jush, me anën e së cilit deklaroni mosekzistencën e shkaqeve për të mos u emëruar në funksionin publik.

Sa më sipër, në mënyrë që të vijohet me emërimin tuaj në pozicionin e propozuar, ju duhet të depozitoni pranë DAP formularin e vetëdeklarimit, brenda 10 ditëve nga ky njoftim, në rast të kundërt do të vijohet me zbatimin e parashikimeve ligjore, të përcaktuara në pikën 3, të kreut II, të Vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

Bashkëlidhur, gjeni kopje të formularit të vetëdeklarimit.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

**DREJTOR DEPARTAMENTI**

**Albana Koçiu**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS PUBLIKE TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS PUBLIKE**

**DREJTORIA E INTEGRITETIT, MBIKËQYRJES DHE ANKESAVE ADMINISTRATIVE E GJYQËSORE**

Nr.4359\6 Prot. Tiranë, më 23.08.2019

**Lënda:** Akt emërimi

**Z. Marjel Mejdini**

Bazuar në nenin 66/1 të Ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil" i ndryshuar, si edhe në Urdhrin Nr. 5151, datë 28.10.2015, "Për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë nga institucionet e administratës shtetërore të përfshira në fushën e zbatimit të ligjit për shërbimin civil", në vijim të propozimit të Komisionit të Posaçëm, të ngritur pranë Departamentit të Administratës Publike, përcjellë me shkresën Nr. 4359/2 prot., datë 22.07.2019, në zbatim të Vendimit nr. 3819 (80-2017-3891), datë 09.10.2017, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, lënë në fuqi me Vendimin nr. 1459, datë 13.05.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit,

**Z. Marjel Mejdini**

emërohet nëpunës civil, në pozicionin "Përgjegjës i Sektorit të Integritetit dhe Mbikëqyrjes, në Drejtorinë e Integritetit, Mbikëqyrjes dhe Ankesave Administrative e Gjyqësore", në Departamentin e Administratws Publike, me kategori page III-a, me kriter specifik shkenca juridike.

**DREJTOR DEPARTAMENTI**

**Albana Koçiu**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS PUBLIKE**

**DREJTORIA E INTEGRITETIT, MBIKËQYRJES DHE ANKESAVE ADMINISTRATIVE E GJYQËSORE**

Nr. 4359/7 prot. Tiranë, më 23. 08 2019

**Lënda:** Përcillet akti i emërimit

**Z. Marjel Mejdini**
Rruga: "Zef Jubani", Pallati "Bjorn", Kati 7, Apartamenti 51,
**Tiranë**

Në vijim të propozimit të Komisionit të Posaçëm, për Zbatimin e Vendimeve Gjyqësore, të ngritur pranë Departamentit të Administratës Publike (DAP), përcjellë me shkresën Nr. 4359/2 prot., datë 22.07.2019, bazuar në Nenin 66/1 të Ligjit Nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, si dhe në Urdhrin Nr. 5151, datë 28.10.2015, "Për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë nga institucionet e administratës shtetërore të përfshira në fushën e zbatimit të ligjit për shërbimin civil", në zbatim të Vendimit nr. 3819 (80-2017-3891), datë 09.10.2017, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, lënë në fuqi me Vendimin nr. 1459, datë 13.05.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit, gjeni bashkëlidhur aktin për emërimin tuaj, në pozicionin "Përgjegjës i Sektorit të Integritetit dhe Mbikëqyrjes, në Drejtorinë e Integritetit, Mbikëqyrjes dhe Ankesave Administrative e Gjyqësore", në DAP, me kategori page III-a, me kriter specifik shkenca juridike.

Risjellim në vëmendjen tuaj që, në respektim të nenit 5, të Ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", i ndryshuar, ju mbartni detyrimin e depozitimit të formularit të vetëdeklarimit, i cili duhet të plotësohet në mënyrë të qartë dhe individualisht prej jush dhe të dorëzohet pranë Departamentit të Administratës Publike, si institucioni përgjegjës për marrjen në dorëzim, administrimin dhe përpunimin e formularëve të vetëdeklarimit për nëpunësit në shërbimin civil.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

**DREJTOR DEPARTAMENTI**

**Albana Koçiu**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS PUBLIKE**

**DREJTORIA E INTEGRITETIT, MBIKËQYRJES DHE ANKESAVE ADMINISTRATIVE E GJYQËSORE**

Nr.4359/9 prot. Tiranë, më 28.08.2019

**Lënda:** Përcillet akti i emërimit

**Z. Marjel Mejdini**
Rruga: "Zef Jubani", Pallati "Bjorn", Kati 7, Apartamenti 51,
**Tiranë**

Në vijim të propozimit të Komisionit të Posaçëm, për Zbatimin e Vendimeve Gjyqësore, të ngritur pranë Departamentit të Administratës Publike (DAP), përcjellë me shkresën Nr. 4359/2 prot., datë 22.07.2019, bazuar në Nenin 66/1 të Ligjit Nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, si dhe në Urdhrin Nr. 5151, datë 28.10.2015, "Për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë nga institucionet e administratës shtetërore të përfshira në fushën e zbatimit të ligjit për shërbimin civil", në zbatim të Vendimit nr. 3819 (80-2017-3891), datë 09.10.2017, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, lënë në fuqi me Vendimin nr. 1459, datë 13.05.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit, gjeni bashkëlidhur aktin për emërimin tuaj, në pozicionin *"Përgjegjës i Sektorit të Integritetit dhe Mbikëqyrjes, në Drejtorinë e Integritetit, Mbikëqyrjes dhe Ankesave Administrative e Gjyqësore", në DAP, me kategori page III-a, me kriter specifik shkenca juridike".*

Risjellim në vëmendjen tuaj që, në respektim të nenit 5, të Ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", i ndryshuar dhe Vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në Ligjin nr. 138/2015, ju mbartni detyrimin e plotësimit të formularit të vetëdeklarimit, të cilin duhet ta depozitoni pranë njësisë përgjegjëse (DAP) brenda 10 ditëve nga ky njoftim.

Në kushtet kur, nga posta shqiptare, shkresa nr. 4359/5 prot., datë 14.08.2019, me lëndë "Mbi ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë", Formulari i Vetëdeklarimit, shkresa nr. 4359/6 prot., datë 23.08.2019, me lëndë "Akte emërimi" dhe shkresa nr. 4359/7 prot., datë 23.08.2019, me lëndë "Përcillet akti i emërimit", janë kthyer me shënimet "e panjohur" dhe "larguar me pushime", në bazë të pikës "b" të nenit nenit 162 të Kodit të Procedurave Administrative, vendosëm njoftimin publik të këtyre akteve, respektivisht në faqen e internetit të DAP dhe në një kënd të posaçëm pranë këtij institucioni. Ndërkohë që një kopje e njoftimit u dërgua dhe në njësinë administrative, ku përfshihet adresa e vendbanimit tuaj.

Ju bëjmë me dije se, në bazë të pikës 3, të nenit 162 të KPA, njoftimi publik vlerësohet i kryer, pas përfundimit të afateve të shpalljes, sipas pikave 1 dhe 2 të këtij neni. Më tej do të vijohet me nxjerrjen e urdhrit për lidhjen e marrdhënieve financiare midis jush dhe DAP.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

**DREJTOR DEPARTAMENTI**

**Albana Koçiu**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

# FORMULAR VETËDEKLARIMI

PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR. 138/2015 "PËR GARANTIMIN E INTEGRITETIT TË PERSONAVE QË ZGJIDHEN, EMËROHEN OSE USHTROJNË FUNKSIONE PUBLIKE"

DATË: _ _ / _ _ / _ _ _ _

## I. TË DHËNAT PERSONALE

### A. Gjeneralitetet aktuale:

| | |
|---|---|
| EMËR | |
| MBIEMËR | |
| ATËSI | |
| AMËSI | |
| DATËLINDJE | |
| VENDLINDJE | |
| VENDBANIM | |
| NR. ID | |

### B. Gjeneralitete të mëparshme:

*(Nëse keni ndryshuar zyrtarisht ndonjë nga të dhënat e gjeneralitetit tuaj, apo keni përdorur një gjeneralitet tjetër, qoftë edhe pa e ndryshuar zyrtarisht, listoni secilin prej tyre, duke plotësuar të gjitha të dhënat që janë ndryshuar dhe aq herë sa janë ndryshuar. Mosdeklarimi i ndonjë gjeneraliteti sipas kësaj pike, që mund të pengojë verifikimin sipas dispozitave të ligjit nr. 138/2015, përbën vepër penale sipas nenit 190 të Kodit Penal.)*

___________________________________________

(emër, mbiemër, nënshkrim)

| | |
|---|---|
| EMËR | |
| MBIEMËR | |
| ATËSI | |
| AMËSI | |
| DATËLINDJE | |
| VENDLINDJE | |

## II. MARRJE DIJENI MBI EFEKTET E FORMULARIT TË VETËDEKLARIMIT

Unë, i/e nënshkruari /a _ _ _ _ _ _ _ _ _ _ _ _ _ kam marrë dijeni dhe jam i vetëdijshëm se:

a) Ky Formular përbën dokument zyrtar që i drejtohet një organi shtetëror dhe i nënshtrohet verifikimit dhe publikimit.

b) Pasqyrimi i të dhënave të rreme në këtë Formular përbën vepër penale dhe dënohet me burgim sipas nenit 190 të Kodit Penal.

c) Të dhënat e pasqyruara në këtë Formular i nënshtrohen verifikimit të plotë, brenda dhe jashtë Shqipërisë, nga organet shtetërore dhe Prokuroria e Përgjithshme.

ç) Me plotësimin e këtij Formulari, kam dhënë pëlqimin për verifikimin e çdo të dhëne personale, përfshirë gjurmët daktiloskopike dhe çdo të dhënë tjetër biometrike.

d) Pasqyrimi i të dhënave të pavërteta, të paplota, dhe të pasakta në këtë Formular dhe refuzimi i depozitimit të gjurmëve daktiloskopike, passjell skualifikimin e menjëhershëm dhe në çdo kohë nga kandidimi/zgjedhja/emërimi apo ushtrimi i mëtejshëm i funksionit publik.

e) Trajtimi i të dhënave do të kryhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

Duke qenë i vetëdijshëm për pasojat ligjore në rast të deklarimeve të pavërteta, të paplota apo të pasakta, konfirmoj saktësinë e të dhënave të pasqyruara në këtë Formular.

KUJDES: JENI I/E SIGURT? SUGJEROHET QË NËNSHKRIMI I KËTIJ SEKSIONI TË BËHET PASI ËSHTË PLOTËSUAR SAKTË I GJITHË FORMULARI!

______________________________________

______________________________________

(emër, mbiemër, nënshkrim)

(emër, mbiemër, nënshkrim)

III. TË DHËNA MBI GJENDJEN GJYQËSORE TË PERSONIT

1. A jeni dënuar ndonjë herë me vendim gjyqësor të formës së prerë nga një autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj?

(vendos X përbri përgjigjes)

PO ☐ JO ☐

Nëse po, specifikoni të dhënat e mëposhtme:

| Të dhënat e vendimit gjyqësor | | | | |
|---|---|---|---|---|
| Gjykata | Nr. dhe data e vendimit gjyqësor të formës së prerë | Masa e dënimit me burgim | Vepra penale për të cilën jeni dënuar | |
| | | | Neni | Lloji |
| | | | | |
| | | | | |
| | | | | |

2. A jeni dënuar me burgim me vendim gjyqësor jo përfundimtar nga një autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj, për një çështje penale të pa zgjidhur me vendim gjyqësor të formës së prerë ?

(vendos X përbri përgjigjes)

PO ☐ JO ☐

Nëse po, specifikoni të dhënat e mëposhtme:

________________________________________

(emër, mbiemër, nënshkrim)

| Të dhënat e vendimit gjyqësor | | | | |
|---|---|---|---|---|
| Të dhënat e vendimit gjyqësor jopërfundimtar | Gjykata | Vepra penale për të cilën jeni dënuar | | Vendimi përfundimtar/Dënimi |
| | | Neni | Lloji | |
| | | | | |
| | | | | |
| | | | | |

3. A keni qenë ndonjë herë në hetim ose gjykim nga një autoritet i huaj, për kryerjen e një vepre penale?

(vendos X përbri përgjigjes)

PO ☐ JO ☐

- Nëse po, specifikoni të dhënat e mëposhtme:

| Organi procedues | Qyteti, Shteti | Arsyet | Periudha/Data | Rezultatet |
|---|---|---|---|---|
| | | | | |
| | | | | |
| | | | | |

4. A keni qenë ndonjëherë i ndaluara po arrestuar nga organet ligjzbatuese, për kryerjen e një vepre penale ?

(vendos X përbri përgjigjes)

PO ☐ JO ☐

- Nëse po, specifikoni të dhënat e mëposhtme:

________________________________________

(emër, mbiemër, nënshkrim)

| Organi procedues | Qyteti, Shteti | Arsyet | Periudha/Data | Rezultatet |
|---|---|---|---|---|
| | | | | |
| | | | | |
| | | | | |

5. A është caktuar ndaj jush ndonjë herë masë shtrënguese e sigurisë personale, në fuqi ose jo?
(vendos X përbri përgjigjes)

PO ☐ JO ☐

- Nëse po, specifikoni të dhënat e mëposhtme:

| MASAT SHTRËNGUESE TË SIGURISË | PËRGJIGJE | |
|---|---|---|
| | Aktualisht në fuqi | E revokuar |
| Ndalimi i daljes jashtë shtetit | | |
| Detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore | | |
| Ndalimi dhe detyrimi i qëndrimit në një vend të caktuar | | |
| Garancia pasurore | | |
| Arresti në shtëpi | | |
| Arresti në burg | | |
| Shtrimi i përkohshëm në një spital psikiatrik | | |

- Nëse po, specifikoni të dhënat e mëposhtme:

________________________________________
(emër, mbiemër, nënshkrim)

| Gjykata | Qyteti, shteti | Vepra penale për të cilën akuzoheshit | | Vendimi përfundimtar | Periudha, data |
|---|---|---|---|---|---|
| | | Neni | Lloji | | |
| | | | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |

6. A është lëshuar ndonjë herë ndaj personit tuaj një urdhër kërkimi ndërkombëtar lidhur me kryerjen e veprave penale?

(vendos X përbri përgjigjes)

PO ☐ JO ☐

- Nëse po, specifikoni të dhënat e mëposhtme:

| Autoriteti urdhërues | Arsyeja | Qyteti, Shteti | Ekzekutimi (nëse është në fuqi apo jo) |
|---|---|---|---|
| | | | |
| | | | |
| | | | |

7. A është marrë ndonjëherë për ju masa e dëbimit nga një shtet i huaj ? (Me pë rjashtim të rastit kur jeni dëbuar ekskluzivisht për shkeljen e rregullave të emigracionit që kanë të bëjnë me rregullat e që ndrimit apo hyrje-daljes në një territor të një shteti të huaj)

(vendos X përbri përgjigjes)

PO ☐ JO ☐

- Nëse po, specifikoni të dhënat e mëposhtme:

____________________________________________

(emër, mbiemër, nënshkrim)

| Qyteti dhe Shteti ku keni jetuar | Arsyeja dëbimit | Periudha e dëbimit nga shteti i huaj | Të dhenat e aktit të dëbimit |
|---|---|---|---|
| | | | |
| | | | |
| | | | |

8. A keni jetuar ndonjë herë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë për më shumë se 1 muaj?

(vendos X përbri përgjigjes)

PO ☐ JO ☐

- Nëse po, specifikoni të dhënat e mëposhtme:

| Qyteti dhe Shteti ku keni jetuar | Arsyeja | Periudha | Adresa e vendqendrimit |
|---|---|---|---|
| | | | |
| | | | |
| | | | |

Duke qenë i vetëdijshëm për pasojat ligjore në rast të deklarimeve të pavërteta, të paplota apo të pasakta, konfirmoj saktësinë e të dhënave të pasqyruara në këtë Formular.

______________________________________

(emër, mbiemër, nënshkrim)

Shënim: *Në rast referimi të akteve, vendimeve dhe dokumenteve të caktuara, bashkëngjitini një kopje të tyre këtij Formulari.*

*Nëse pjesë të caktuara të Formularit janë të pamjaftueshme për deklarimin e të dhënave, shto aq pjesë sa ju nevojiten për pasqyrimin e të gjitha të dhënave.*

______________________________________

(emër, mbiemër, nënshkrim)